

FONDI RAIFFEISEN INVEST MIKS

Pasqyrat financiare
më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
(me raportin e Audituesit të pavarur bashkëlidhur)

Përmbajtja

Raporti i Audituesit të pavarur i-iii

Pasqyrat Financiare

Pasqyra e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	1
Pasqyra e pozicionit financiar	2
Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto	3
Pasqyra e flukseve monetare	4
Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare	5-25

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për aksionarët e “Raiffeisen Invest” sh.a, Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Fondit të Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, “Fondi MiKS”, (këtu e më poshtë i referuar si “Fondi”), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2023 dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe nga një përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Fondit më 31 dhjetor 2023 si edhe të performancës së saj financiare dhe parave për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”).

Baza e Opinionit

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (“SNA”-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar “Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare” të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Shoqëria në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (kodi “BKSNE”) dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me kodin BKSNE.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë informacionet që paraqiten në raportin vjetor, për gatitur nga Drejtimi në përputhje me nenin 121 të ligjit nr. 56/2020 për “Sipërmarrjet e investimeve kolektive”, i ndryshuar, por nuk përfshin pasqyrat financiare dhe raportin tonë të audituesit mbi këto pasqyra. Raporti vjetor parashikohet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit të pavarur. Opinionit ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim asnjë lloj opinionit në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera, të identifikuar më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë pasaktësi materiale me pasqyrat financiare, apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me anomali materiale. Kur të lexojmë Raportin Vjetor, nëse, në bazë të punës që kemi kryer, arrijmë në përfundimin se ka një anomali materiale të informacioneve të tjera, ne na kërkohet të raportojmë këtë fakt. Nuk kemi asgjë për të raportuar për këtë fakt.

Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Fondit për të vazhduar aktivitetin e tij në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënimet shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Fondit dhe të përdorë parimin kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi ka ose për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveç se sa më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Fondit.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Gjithashtu, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të përshtatshme me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e sistemeve të kontrolleve të brendshme të Fondit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Fondit për të vazhduar në vijimësi.

Nëse arrijmë në përfundimin se ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit me reference në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit të audituesit tonë. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërpreje të aftësisë së Bankës për vazhduar në vijimësi.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)

- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet thelbësore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.

Ne komunikojmë me palët e ngarkuara me qeverisjen e Fondit, ku përveç çështjeve të tjera, komunikojmë edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm që është identifikuar gjatë auditimit tonë.

Deloitte Audit Albania shpk

Deloitte Audit Albania shpk

Rruga e Kavajës, ish parku i mallrave, Kompleksi Delijorgji, Godina H

Tirana, Albania

Numër unik identifikimi i subjektit (NUIS): L41709002H

Audituesi ligjor

Partner Angazhim

Enida Cara



Tiranë, Shqipëri

29 mars 2024

Fondi Raiffeisen Invest Miks

Pasqyra e të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

	Shënime	2023	2022
Të ardhura			
Të ardhura nga interesat	10	4,286	5,098
Të ardhura të tjera operative		1,541	2,421
		<u>5,828</u>	<u>7,519</u>
Shpenzime			
Nryshime në vlerën e drejtë të instrumentave financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes	11	15,596	(61,189)
Tarifa e Shoqërisë së Administrimit	18	(3,178)	(5,201)
Shpenzime të tjera operative		(747)	(1,436)
Humbje neto nga kursi i këmbimit	12	(21,648)	17,883
		<u>(9,976)</u>	<u>(49,943)</u>
Rritja në aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave		<u>(4,148)</u>	<u>(42,424)</u>

Pasqyra e fitimit ose e humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 5 deri në 25, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Fondi Raiffeisen Invest Miks

Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2023

(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
AKTIVET			
Paraja dhe ekuivalentë të saj	15	32,188	7,186
Llogari të arkëtueshme të tjera		25	43
Aktive financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet të fitimit ose humbjes	13	184,203	137,887
Kuota në fonde investimit me vlerë të drejte nëpërmjet fitimit ose humbjes	14	104,219	98,586
TOTALI I AKTIVEVE		320,635	243,701
DETYRIMET			
Detyrime ndaj Shoqërisë së Administrimit		292	275
Të pagueshme për kërkesa tërheqje nga fondi		-	-
Detyrime të tjera	16	261	448
TOTALI I DETYRIMEVE		552	723
AKTIVET NETO QË I ATRIBUOHEN MBAJTËSVE TË KUOTAVE	17	320,083	242,979
Numri i kuotave të emetuara të Fondit (Në mijë)		31,295	23,261
AKTIVET NETO PËR NJËSI NË LEK		10,228	10,446

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 5 deri në 25, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë miratuar më 21 Mars 2024 në emër të Fondit nga Këshilli i Administrimit të Raiffeisen INVEST – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a. dhe u firmosën nga:

Administratore e Përgjithshme
Znj. Edlira KONINI



Zv. Administratore e Përgjithshme
Znj. Alketa EMINI

Fondi Raiffeisen Invest Miks

Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

	Shënime	2023	2022
Aktive neto që i atribuohen kontribuesve më 1 janar		242,979	534,143
Kontribute		103,520	47,027
Tërheqje		(22,268)	(295,768)
		<u>324,231</u>	<u>285,403</u>
Rritja në aktivet neto që i atribuohen kontribuesve nga operacionet		(4,148)	(42,424)
Aktive neto (të detyrueshme nga)/të atribueshme ndaj kontribuesve	17	<u>320,083</u>	<u>242,979</u>
NUMRI I KUOTAVE TË INVESTIMIT NË MIJË			
Të afzuara/emetuara bazuar në kontribute		10,186	3,906
Të tërhequra nga mbajtësit e kuotave		(2,152)	(22,895)
RRITJE NË NUMRIN E KUOTAVE TË FONDIT		<u>8,034</u>	<u>(18,989)</u>

Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 5 deri në 25, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Fondi Raiffeisen Invest Miks

Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

	Shënime	2023	2022
Flukse monetare nga aktiviteti operacional (Ulja)/Rritja në aktivet neto që i atribuohet kontribuuesve		(4,148)	(42,425)
Rregullime për:			
Humbe/(Fitime) të perealizuara nga rivlerësimi i aktiveve financiare të mbajtura në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes	11	(13,631)	11,752
Të ardhura nga interesi		(4,286)	(5,097)
Humbjet nga këmbimi në para dhe ekuivalentët e saj		(582)	(2,331)
Mjete monetare neto nga aktiviteti operativ		(22,648)	(38,101)
Ndryshimet në:			
Instrumentat financiare me VDNFH		(33,869)	92,852
Kuota në fonde investimi		(5,270)	111,640
Të pagueshme ndaj shoqërisë administruese		17	(301)
Llogari të tjera të arkëtueshme		(18)	(157)
Detyrime të tjera		(187)	66
		(61,976)	204,100
Interes i arkëtuar		5,223	8,862
Flukset e parasë të përdorura në aktivitetet operacionale		(56,753)	212,962
Flukset monetare nga aktiviteti financues			
Kontribute të arketuara nga mbajtesit e kuotave		103,520	47,027
Kontribute të paguara ndaj mbajtësve të kuotave		(22,347)	(260,138)
Flukset monetare neto nga aktiviteti financues		81,173	(213,111)
Rritje neto në flukset e parasë		24,420	(38,250)
Paraja dhe ekuivalentë të saj në fillim të vitit		7,186	43,105
Humbjet nga këmbimi në para dhe ekuivalentët e saj		582	2,331
Paraja dhe ekuivalentë të saj në fund të vitit	17	32,188	7,186

Pasqyra e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 5 deri në 25, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Fondi Raiffeisen Invest Miks

Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

1. Informacion i përgjithshëm

Fondi i investimit Raiffeisen Invest Mix ("Fondi") është një fond investimi me ofertë publike i licensuar nga Autoriteti i Mbykqyrjes Financiare ("AMF") bazuar në ligjin nr. 10198 më datë 10 Dhjetor 2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive" dhe bazuar në vendimin nr. 153 më datë 23 Tetor 2020.

Aktivitetet investuese të fondit manaxhohen nga Raiffeisen INVEST sh.a – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive ("Shoqëria Adminstruese").

Objektivi i Fondit është që ti japë investitorit një kthim nga investimi në përputhje me një menaxhim të kujdesshëm të portofolit, duke ruajtur nivelin e kapitalit dhe të likuiditetit të nevojshëm.

Te ardhurat nga investimi në Fond janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat personale dhe lidhen me të ardhurat kapitale të kontribuesve të cilat tatohen në normën 15%. Shoqëria administruese vepron si një agjent mbledhës në emër të Fondeve.

Fondi ofron investimin në kuota një grupi të gjerë investitorësh të cilët janë kryesisht individë.

Mbështetur në Ligjin nr. 10197, datë 10.12.2009, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka miratuar Bankën e Parë të Investimeve si bankë depozitare e Fondit të Investimit Raiffeisen Invest Miks ("Depozitari"). Shoqëria Administruese dhe Depozitari do të mbajnë aktivet, veprimet dhe regjistrimet e veta të ndara nga aktivet, veprimet dhe regjistrimet kontabël të Fondit të Investimit Raiffeisen Invest Miks.

Këshilli i Administrimit si organi qendror i Fondit përbëhet nga 7 anëtarë si më poshtë:

Znj. Donalda GJORGA	Kryetar
Z. Peter ZILINEK	Zv.kryetar
Z. Erjon BALLI	Anëtar
Znj. Elona LLACI	Anëtar
Znj.Gentjana CICERI	Anëtar
Znj. Edlira KONINI	Anëtar
Znj. Alketa EMINI	Anëtar

Administratorët janë:

Znj. Edlira Konini	Administratore e Përgjithshme
Znj Alketa Emini	Zv/Administratore e Përgjithshme

Fondi Raiffeisen Invest Miks

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

2. Baza e përgatitjes

2.1 Paraqitja e pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare të fondit janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF"). Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 janë të miratuara nga Drejtimi i Fondit më datë 21 Mars 2024.

2.2 Parimi i vijimësisë

Ecuria e aktiveve të fondit dhe kthimi nga investimi

Sipas raportimit për tremujorin e katërt të vitit 2023 për Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare, vlera neto e aktiveve të fondit Raiffeisen Mix, ka pësuar një rritje prej 31.73% krahasuar me vlerën më 31 dhjetor 2022, ndërsa numri i kuotave është rritur përkatësisht me 34.54%, duke shënuar një normë kthimi totale për fondin prej 7.68 % (31 dhjetor 2022: -12.65%), në varësi dhe të ndryshimit të kurseve të këmbimit gjatë periudhës raportuese.

Ecuria e likuiditetit

Sipas raportimit për tremujorin e fundit të vitit 2023 për Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare tregon një nivel aktual më të lartë të rezervës së likuiditetit (Aktivet Likuide me Cilësi të Lartë ALCL) sesa kërkesat rregullore për likuiditet. Fondi konsiderohet të ketë një nivel të përshtatshëm likuiditeti për të përmbushur shlyerjet e investitorëve të tij si dhe detyrimet e tjera.

Fondi ka një nivel të Aseteve Likuide me Cilësi të Lartë (ALCL) që përbëhet nga mjete monetare ose aktive që mund të konvertohen në para me një humbje të vogël ose aspak të vlerës prej 63.70%.

Prova e rezistencës

Fondi kryen provat e rezistencës për të përlogaritur likuiditetin e nevojshëm në rastin e skenarëve të përkeqësuar të tregut. Në vijim ajo ka përcaktuar raportin e likuiditetit në varësi të tërheqjeve neto që parashikohen gjatë një skenari të përkeqësuar për një periudhë javore për ekspozimet e mëdha dhe tremujore për ekspozimet mesatare. Në analizë merret parasysh dhe koha e nevojshme për shlyerjen e investimeve për të përballuar flukset e pritshme dalëse, duke filluar nga 3 ditë deri në 3 muaj.

Në bazë të supozimeve të skenarit të analizuar, vlerësohet se fondi mund të arrijë të përballojë veshtirësitë e mundshme të supozuara, duke qënë në përputhje edhe me kufizimet rregullore në lidhur me likuiditetin brenda afatit ligjor, nga ku vlerësohet se periudha minimale e mbulimit të flukseve është 3 muaj.

Bazuar në analizat e mësipërme, Drejtimi ka siguri të mjaftueshme se nuk ekzistojnë pasiguri materiale, që mund të ndikojnë në aftësinë e Fondit për të operuar sipas parimit të vijimësisë në të ardhmen e parashikuar. Për këtë arsye, përgatitja e pasqyrave financiare sipas parimit të vijimësisë konsiderohet e përshtatshme më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022.

3. Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek shqipëtar ("Lek"), e cila është monedha funksionale për Fondin. Fondi e konsideron Lekun si monedhën që përfaqëson më besnikërisht efektin ekonomik të transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve bazë. Leku është monedha në të cilën Fondi mat performancën e tij dhe raporton rezultatet e tij dhe për këtë arsye monedhën funksionale dhe paraqitjen. Ndërsa Euro është monedha në të cilën ajo merr abonime nga investitorët e saj dhe monedhën bazë të strategjisë së investimeve të Fondit. Kjo vendosmëri gjithashtu konsideron mjedisin konkurrues në të cilin është Fondi, krahasuar me fondet e tjera të investimit.

4. Bazat e matjes

Keto pasqyra financiare janë përgatitur bazuar në koston historike, përveç instrumentave financiare jo-derivative të mbajtura në VDNFH dhe VDNAGJ të cilët janë matur me vlerën e drejte.

5. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi i Fondit të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve.

Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga çmuarjet. Çmuarjet dhe supozimet përkatëse rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve njihen në mënyrë prospektive.

Gjykime dhe vlerësime

Informacioni për gjykimet e bëra në aplikimin e politikave kontabël që kane efektet më të rëndësishme në vlerat e njohura në pasqyrat financiare janë të përfshira në shënimin e mëposhtëm:

- Shënimi 3, 8 – përcaktimi i monedhës funksionale;
- Shënimi 9 – përcaktimi i vlerës së drejtë të instrumenteve financiare me të dhëna kryesisht të pavrojtueshme
- Shënimi 14 – përfshirja me entitete të strukturuar të pakonsoliduara.

6. Ndryshimet në politikat kontabël

a) Standardet dhe interpretimet në fuqi në periudhën aktuale

Në vitin aktual, Shoqëria ka aplikuar një sërë ndryshimesh në Standardet e Kontabilitetit të SNRF-ve të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) që janë të detyrueshëm në fuqi për periudhën raportuese që fillon më ose pas 1 janarit 2023:

- **SNRF 17 “Kontratat e sigurimit”** (publikuar më 18 maj 2017 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023). Adoptimi i standardit nuk pati një ndikim material në këto pasqyra financiare të veçanta.
- **Ndryshimet në SNRF 17 dhe një ndryshim në SNRF 4** (publikuar më 25 qershor 2020 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2023). Ndryshimet përfshijnë një numër sqarimesh që synojnë të lehtësojnë zbatimin e SNRF 17, të thjeshtojnë disa kërkesa të standardit dhe të tranzicionit. Ndryshimet lidhen me tetë fusha të SNRF 17 dhe ato nuk synojnë të ndryshojnë parimet themelore të standardit. Adoptimi i standardit nuk pati një ndikim material në këto pasqyra financiare të veçanta.
- **Opsioni i tranzicionit për siguresit që zbatojnë SNRF 17 – Ndryshimet në SNRF 17** (publikuar më 9 dhjetor 2021 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023). Adoptimi i standardit nuk pati një ndikim material në këto pasqyra financiare të veçanta.
- **Ndryshime në SNK 1 dhe Deklarata e Praktikës 2 të SNRF**: Dhënia e informacioneve shpjeguese të politikave kontabël (publikuar më 12 shkurt 2021 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023). Adoptimi i standardit nuk pati një ndikim material në këto pasqyra financiare të veçanta.
- **Ndryshime në SNK 8: Përkufizimi i Vlerësimeve Kontabël** (publikuar më 12 shkurt 2021 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023). Amendamenti i SNK 8 sqaroi se si kompanitë duhet të dallojnë ndryshimet në politikat kontabël nga ndryshimet në vlerësimet kontabël. Miratimi i ndryshimeve nuk pati një ndikim material në këto pasqyra financiare të veçanta.
- **Tatimi i shtyrë në lidhje me aktivet dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm – Ndryshimet në SNK 12** (publikuar më 7 maj 2021 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2023). Ndryshimi nuk pati një ndikim material në këto të veçanta financiare deklaratat.

Zbatimi i ndryshimeve të mësipërme nuk pati ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të veçanta të Bankës.

Fondi Raiffeisen Invest Miks

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

6. Ndryshimet në politikat kontabël (vazhdim)

b) Deklaratat e reja të kontabilitetit

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e reja të mëposhtme, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimet e reja ishin në qarkullim, por ende nuk janë në fuqi. Drejtimi parashikon që të gjitha njoftimet përkatëse do të miratohen për periudhën e parë që fillon në ose pas datës efektive të publikimit. Kompania nuk pret që adoptimi i Standardeve të listuara më sipër do të ketë një ndikim material në pasqyrat financiare të Kompanisë në periudhat e ardhshme.

- **Ndryshimet në SNRF 16 Qiratë:** Detyrimi i Qirasë në një shitje dhe kthimi i qirasë (publikuar më 22 shtator 2022 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2024).
- **Klasifikimi i pasiveve si afatshkurtëra ose afatgjata – Ndryshime në SNK 1** (fillimisht i publikuar më 23 janar 2020 dhe i ndryshuar më pas më 15 korrik 2020 dhe 31 tetor 2022, përfundimisht në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2024).
- **Ndryshime në SNK 7 Pasqyra e Flukseve të Parasë dhe SNRF 7 Instrumentet Financiare:** Dhënia e informacioneve shpjeguese: Marrëveshjet financiare të furnizuesit (Lëshuar më 25 maj 2023). Ndryshimet nuk prekin parimet e njohjes ose të matjes, por vetëm kërkesat e zbulimit. Kërkesat e reja për dhënie informacionesh shpjeguese do të jenë efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2024.

Përveç nëse përshkruhet ndryshe më lart, standardet dhe interpretimet e reja nuk pritet të ndikojnë ndjeshëm në pasqyrat financiare të Bankës. Drejtimi parashikon që të gjitha njoftimet përkatëse do të miratohen për periudhën e parë që fillon ose pas datës efektive të publikimit.

7. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

a) Transaksione në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksioneve. Aktivitetet dhe detyrimet monetare të shprehura në monedhë të huaj në datën e raportimit janë rikonvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në atë datë. Aktivitetet dhe detyrimet jo-monetare të shprehura në monedha të huaja që maten me vlerën e drejtë, konvertohen në monedhën funksionale në kursin e këmbimit në datën kur përcaktohet vlera e drejtë. Zërat jo-monetarë që maten në bazë të kostos historike në një monedhë të huaj janë përkthyer duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat në valutë të huaj që rrjedhin nga përkthimi njihen në fitim ose humbje.

b) Të ardhurat nga interesi dhe të ardhura të ngjashme

Interesi njihet në bazë proporcionale kohore duke përdorur metodën efektive të interesit. Të ardhurat e interesit përfshijnë interesa nga para në dorë dhe ekuivalente në para (depozita afatshkurtra). Të ardhurat nga pasuritë financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes përfshijnë interesat nga sigurimet e borxhit.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitura në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse përfshijnë interesin mbi aktivitetet financiare dhe detyrimet financiare të matura me koston e amortizuar të llogaritur mbi bazën e interesit efektiv. 'Norma efektive e interesit' llogaritet në njohjen fillestare të një instrumenti financiar si norma që skanton saktësisht pagesat ose arkëtimet e ardhshme të parave të gatshme gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar në: vlerën kontabël bruto të aktivitetit financiar; ose koston e amortizuar të detyrimit financiar. Në llogaritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve nga interesi, norma efektive e interesit zbatohet në vlerën kontabël bruto të aktivitetit (kur aktiviteti nuk është i zhvlerësuar nga kredia) ose në koston e amortizuar të pasivitetit.

c) Tarifat dhe shpenzimet e komisioneve

Shpenzimet e tarifave dhe komisioneve njihen në fitim ose humbje kur merren shërbimet e lidhura me to.

d) Tatimi mbi të ardhurat

Sipas sistemit aktual të taksimit në Shqipëri, Fondi është i përjashtuar nga pagimi i tatimit mbi të ardhurat. Megjithatë, disa të ardhura nga dividendët dhe interesat e marra nga Fondi i nënshtrohen tatimit në burim të vendosur në disa vende të origjinës. Të ardhurat që i nënshtrohen këtij tatimi njihen bruto nga taksat dhe tatimi korrespondues i mbajtur në burim njihet si shpenzim tatimor.

7. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

e) Instrumentet financiare

(i) Njohja dhe matja fillestare

Fondi njeh aktivet dhe detyrimet financiare me VDNFH në datën e tregëtimit, e cila është data kur Fondi bëhet palë e provizionit kontraktual të instrumentit. Aktivet dhe detyrimet e tjera financiare njihen në datën kur ato krijohen. Një aktiv financiar ose detyrim financiar, në njohjen fillestare do të matet me vlerën e drejtë të tij plus, në rastin e elementëve të përcaktuar jo me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, koston e transaksionit që i ngarkohet drejtpërdrejt blerjes ose emetimit.

(ii) Klasifikimi dhe matja e mëpasshme

Aktivët financiarë

Në njohjen fillestare, aktivi financiar (me përjashtim të Mjeteve monetare, Depozitave, Marrveshjeve të Riblerjes (Repo)) klasifikohet si të matur me VDNFH. Aktivët financiarë nuk riklasifikohen pas njohjes fillestare, përveç nëse Fondi ndryshon modelin e saj të biznesit për menaxhimin e aktiveve financiare, në këtë rast të gjitha aktivët financiarë të ndikuara riklasifikohen në ditën e parë të periudhës së parë raportuese pas ndryshimit në modelin e biznesit.

Mjetet monetare, depozitat dhe Marrveshjet e Riblerjes (Repot) klasifikohen si të matura me kosto të amortizuar. Depozitat dhe Marrveshjet e Riblerjes (Repot) nuk riklasifikohen pas njohjes fillestare të tyre, përveç rasteve kur Kompania ndryshon modelin e saj të biznesit për administrimin e aktiveve financiare, në të cilin rast të gjitha aktivët financiarë të prekura riklasifikohen në ditën e parë të periudhës së parë raportuese pas ndryshimit në modelin e biznesit.

Vlerësimi i modelit të biznesit

Fondi vlerëson objektivat e modeleve të biznesit sipas të cilave menaxhohet një aktiv në nivel portofoli sepse kjo reflekton mënyrën më të mirë sesi menaxhohet biznesi dhe si informacioni i paraqitet drejtimit.

Transferimi i aktiveve financiare me palë të treta me anë të transaksioneve që nuk i plotësojnë kushtet për çregjistrim, nuk konsiderohen shitje për këtë qëllim, në përputhje me njohjen në vazhdimësi të aktiveve të Fondit. Fondi ka përcaktuar se ka një model biznesi që përfshin investimet në letrat me vlerë dhe investimet në fondet e investimeve të palistuar. Këto mjete financiare menaxhohen dhe performanca e tyre vlerësohet, në bazë të vlerë së drejtë, me shitjet e shpeshta që ndodhin. Modeli i biznesit për Mjetet monetare, depozitat dhe Marrveshjet e Riblerjes është 'held to collect'.

Për qëllim të këtij vlerësimi, 'principal' është vlera e drejtë e aktivit financiar në njohjen fillestare. 'Interesi' është shpërblimi për vlerën në kohë të parasë dhe për rrezikun e kredisë të lidhur me shumën e principalit të pashlyer gjatë një periudhe kohore të caktuar, për rreziqet dhe kostot e tjera bazë të kreditimit (p.sh, rreziku i likuiditetit dhe kostot administrative), duke përfshirë gjithashtu marzhin e fitimit.

Për të vlerësuar nëse flukset monetare kontraktuale janë pagesa vetëm të principalit dhe interesit, Fondi merr parasysh kushtet kontraktuale të instrumentit. Kjo përfshin vlerësimin nëse një aktiv financiar përmban një element kontraktual që mund të ndryshojë kohën ose shumën e flukseve monetare kontraktuale në mënyrë të tillë që nuk plotëson kushtin.

Gjatë vlerësimit, Fondi konsideron:

- ngjarje të kushtëzuara që mund të ndryshojnë kohën dhe shumën e flukseve monetare;
- kushte që mund të ndryshojnë normën kontraktuale të interesit, përfshirë normat e ndryshueshme;
- parapagimet dhe kushtet e shtyrjes; dhe
- kushtet që kufizojnë pretendimet e Fondi për flukset monetare nga aktive të caktuara (tipare të pakthyeshme)

Nëse kushtet e një aktivi financiar modifikohen, Fondi vlerëson nëse flukset monetare të aktivit të modifikuar janë thelbësisht të ndryshme.

Nëse flukset e mjeteve monetare janë thelbësisht të ndryshme, atëherë të drejtat kontraktuale për flukset monetare nga aktivi financiar origjinal konsiderohen se kanë skaduar. Në këtë rast, aktivi financiar fillestar çregjistrohet (shih (iii)) dhe një aktiv i ri financiar njihet me vlerën e drejtë.

7. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

c) Instrumentat financiarë (vazhdim)

Nëse flukset monetare të aktivitetit të modifikuar të mbajtura me kosto të amortizuar nuk janë thelbësisht të ndryshme, atëherë modifikimi nuk rezulton në çregjistrimin e aktivitetit financiar. Në këtë rast, Fondi rillogarit vlerën kontabël bruto të aktivitetit financiar dhe njeh shumën që rrjedh nga rregullimi i vlerës kontabël bruto si një fitim ose humbje modifikuese në fitim ose humbje. Nëse një modifikim i tillë kryhet për shkak të vështirësive financiare të huamarrësit (shih (vii)), atëherë fitimi ose humbja paraqitet së bashku me humbjet nga zhvlerësimi. *Detyrimet financiare - Klasifikimi, matjet e mëpasshme dhe fitimet dhe humbjet*

Detyrimet financiare klasifikoheshin si të matura me koston e amortizuar dhe pas njohjes fillestare ato mateshin me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet e interesit dhe fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit dhe zhvlerësimi njiheshin në fitim ose humbje. Çdo fitim ose humbje në momentin e çregjistrimit, njihet në fitim ose në humbje.

Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur kushtet e tij kontraktuale ndryshojnë dhe flukset e mjeteve monetare të detyrimit të modifikuar ndryshojnë thelbësisht. Në këtë rast njihet, një detyrim i ri financiar i bazuar në kushtet e modifikuara, njihet me vlerën e drejtë. Diferenca midis vlerës kontabël neto dhe shumës së paguar njihet në fitim ose humbje.

Nëse modifikimi i një detyrimi financiar nuk llogaritet si mosnjohje, atëherë kostoja e amortizuar e detyrimit rillogaritet duke skontuar flukset e modifikuara të mjeteve monetare me normën fillestare të interesit efektiv dhe fitimi ose humbja që rezulton njihet në fitim ose humbje.

(iii) Matja e vlerës së drejtë

Vlera e drejtë' është çmimi që do të arkëtohej nga shitja e një aktivi ose që do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut, në datën e matjes në një treg kryesor ose, në mungesë të tij, në tregun më të favorshëm tek i cili Fondi ka qasje në atë datë. Vlera e drejtë e një pasivi pasqyron rrezikun e tij të mosekzekutimit. Kur është e mundur, Shoqëria mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Një treg quhet "aktiv", në qoftë se transaksionet për aktivin ose detyrimin ndodhin me frekuencë dhe vëllim të mjaftueshëm për të siguruar informacion mbi çmimet në vazhdimësi.

Nëse nuk disponohet një kuotim çmimi në një treg aktiv, atëherë Shoqëria përdor teknika vlerësimi që maksimizojnë përdorimin e të dhënave të vrojtueshme dhe minimizojnë përdorimin e të dhënave jo të vrojtueshme. Teknika e zgjedhur përmbledh të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të marrin në konsideratë për përcaktimin e çmimit të një transaksioni- dmth. Vlera e drejtë e shumës së dhënë ose të marrë.

Nëse Fondi përcakton se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe vlera e drejtë nuk dëshmohet as nga një çmim i kuotuar në treg për një aktiv apo detyrim identik dhe as i bazuar në një teknikë vlerësimi që përdor vetëm të dhëna nga tregjet e vrojtueshme, atëherë instrumenti financiar fillimisht matet me vlerë të drejtë, përshtatur për të evidentuar dallimin midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimit të transaksionit. Më pas, ky dallim njihet në fitim ose humbje mbi një bazë të përshtatshme mbi jetën e instrumentit, por jo më vonë se kur vlerësimi mbështetet plotësisht nga të dhënat e vëzhgueshme të tregut ose transaksioni është mbyllur. Fondi njeh transferimet midis niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë si në fund të periudhës raportuese, gjatë së cilës ka ndodhur ndryshimi.

Matja e koston së amortizuar

'Kostoja e amortizuar' e një aktivi financiar ose detyrimi financiar është shuma me të cilën matet aktivi financiar ose detyrimi financiar në njohjen fillestare minus shlyerjet e principalit, plus ose minus amortizimin kumulativ duke përdorur metodën e interesit efektiv të çdo difference midis shumës fillestare dhe asaj të maturuar. Për aktivet financiare, kjo shumë rregullohet për çdo provizion për humbje.

Fondi Raiffeisen Invest Miks

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

7. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

d) Investimet në letrat me vlerë

Investimet në letra me vlerë përfshijnë bono thesari të matura në vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Referohu Shënimit 8 (b).

e) Mjetet Monetare dhe ekuivalentet e saj

Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e saj përfshijnë aktive financiare mjaft likuidë me maturitet tre muaj ose më pak nga data e blerjes, të cilat janë subjekt i një rreziku jo të rëndësishëm të ndryshimeve në vlerën e drejtë, dhe përdoren nga Fondi për menaxhimin e angazhimeve afatshkurtra. Mjetet Monetare dhe ekuivalentet e saj mbahen me kosto të amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

f) Llogari të tjera të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerë të drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar dhe maten me koston e tyre të amortizuar duke zbritur humbjet nga zhverësimet.

g) E pagueshme për tërheqjet nga fondi

Të pagueshme për kërkesë tërheqjet nga fondi maten me koston e tyre të amortizuar. Fondi emeton kuota të shlyeshme, me kërkesë të investitorit. Çdo investitor që ka bërë shlyerje të kuotave të tij, mund të ri-investojë në Fond nëpërmjet depozitimit të mjeteve monetare ekuivalente me vlerën e kuotave të kërkuara. Kuotat janë të shlyeshme çdo ditë. Në momentin e kërkesës për shlyerje, kuotat që do të shlyhen mbarten në vlerën e shlyerjes si detyrim i pagueshëm në pasqyrën e pozicionit financiar të Fondit. Çmimi i kuotave të shlyeshme bazohet në vlerën neto të asetit të Fondit për njësi në kohën kur është bërë një kërkesë e vlefshme për shlyerje.

h) Vlera neto e pasurive

Vlera neto e aktiveve është e barabartë me vlerën totale të aktiveve neto minus detyrimet e Fondit. Vlera e kuotës së Fondit është e barabartë me vlerën neto të aktiveve pjesëtuar me numrin total të kuotave në datën e raportimit. Bazuar në politikat e Fondit, vlera kuotes në nisjen e Fondit ishte e barabartë me Euro 100.

i) Tarifa e Shoqërisë Administruese

Fondi duhet t'i paguajë Kompanisë së Administrimit një tarifë prej 1.30% në vit (2022- 1.30%) të vlerës së aktiveve neto, si një shpenzim i cili llogaritet në baza ditore.

j) Fitimet / humbjet e përcaktuar

Fitimi ose humbja e përcaktuar përfaqëson diferencën midis vlerës kontabël të një instrumenti financiar në fillim të periudhës, ose çmimit të transaksionit nëse është blerë në periudhën aktuale të raportimit, dhe vlerës së tij kontabël në fund të periudhës raportuese.

k) Fitimi/humbja e realizuar

Fitimi ose humbja e realizuar përfaqëson diferencën midis vlerës kontabël të një instrumenti financiar në fillim të periudhës, ose çmimit të transaksionit nëse është blerë në periudhën aktuale të raportimit, dhe vlerës së tij kontabël në fund të periudhës raportuese. Keto diferenca transferohet në fitim/ humbje për periudhën.

Fondi Raiffeisen Invest Miks

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

8. Administrimi i rrezikut financiar

a) Pamje e përgjithshme

Aktivitetet e Fondit e ekspozojnë atë ndaj një shumëllojshmërie rreziqesh financiare: rrezikut të tregut (duke përfshirë rrezikun e këmbimit valutor, rrezikun e normës së interesit dhe rreziqe të tjera të çmimeve), rrezikut të kredisë dhe rrezikut të likuiditetit. Fondi është i ekspozuar edhe ndaj rreziqeve operacionale të tilla si rreziku i kujdestarisë. Rreziku i kujdestarisë është rreziku i humbjes së letrave me vlerë të mbajtura në kujdestari të shkaktuar nga neglizhenca e kujdestarit. Edhe pse është vendosur një kuadër i përshtatshëm ligjor që eliminon rrezikun e humbjes së vlerës së letrave me vlerë të mbajtura nga kujdestari, në rast të dështimit të saj, aftësia e Fondit për të transferuar letrat me vlerë mund të dëmtohet përkohësisht. Programi i përgjithshëm i menaxhimit të rrezikut të Fondit kërkon të maksimizojë kthimin që vjen nga niveli i rrezikut për të cilat Fondi është i ekspozuar dhe kërkon për të minimizuar efektet e mundshme negative mbi performancën financiare të Fondit.

Bazuar në Ligjin Nr. 10198, datë 10 Dhjetor 2009 “Per Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, Shoqëria Administruese ka në strukturat e saj një Njësi Menaxhimi të Rrezikut, përgjegjëse për menaxhimin e rrezikut dhe raportimin e tij tek Bordi i Administrimit. Politikat e menaxhimit të rrezikut të Fondit krijohen për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat ballafaqohet institucioni financiar, për të vendosur kufizimet dhe kontrollet e përshtatshme të rrezikut dhe për të monitoruar rreziqet dhe respektimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të pasqyruar ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara. Fondit, përmes standardeve dhe procedurave të menaxhimit, synon të zhvillojë një mjedis kontrolli të disiplinuar dhe konstruktiv, në të cilin të gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

b) Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare të Fondit nëse një klient ose një palë tjetër e një instrumenti financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet e tij kontraktuale, pjesërisht ose plotësisht gjë që sjell efekt negativ në aktivet e Fondit. Ky rrezik vjen kryesisht nga mbajtja e letrave me vlerë dhe gjithashtu nga mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre.

Bordi i Administrimit të Fondit ka deleguar përgjegjësinë për menaxhimin e rrezikut të kredisë për Drejtimin, i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e rrezikut të kredisë të Fondit. Investimet e Fondit janë në bono thesari dhe obligacione të Qeverisë Shqiptare dhe për këtë arsye Fondi ekspozohet vetëm ndaj rrezikut të kredisë të qeverisë shqiptare. Vlera kontabël e aktiveve financiare përfaqëson ekspozimin maksimal të kredisë. Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë në datën e raportimit ishte:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Aktive financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet të fitimit ose humbjes	184,203	137,887
Kuota në fonde investimi	104,219	98,586
Paraja dhe ekuivalentë të saj	32,188	7,186
Totali	320,610	243,659

Cilësia e kredisë së aktiveve financiare është si vijon:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Qeveria Shqiptare B+*	116,750	102,796
Qeveria e Maqedonis së Veriut BB-		5,845
Qeveri të tjera ne grade investimi	30,449	
Obligacione të korporatave AA - Baa2		18,143
Obligacione të korporatave BB+		11,102
Obligacione të korporatave A - BBB-	37,005	
Kuota në fonde investimi	104,219	98,586
Mjete Monetare dhe ekuivalentët	32,188	7,186
Vlera e mbartur	320,610	243,659

Fondi Raiffeisen Invest Miks

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

8. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Mjete Monetare dhe ekuivalentët janë të mbajtuara në banka vendase, të cilat janë të parankuara.

Kuotat në fonde investimi janë të vendosura kryesisht në Austri dhe janë të lidhura me grupin “Raiffeisen Bank International” me rating A3 sipas Moody’s për vitin 2023.

Mjete monetare dhe ekuivalentët e saj

Mjete monetare dhe ekuivalentët e saj mbahen në bankat tregtare në Shqipëri. Fondi zbaton një model të humbjeve të pritshme dhe paraqet ekspozimet me maturim afatshkurtër në përcaktimin e zhvlerësimit e parasë dhe ekuivalentëve të saj.

Fondi nuk ka njohur humbje zhvlerësimi më dhe gjatë vitit 2023 për mjetet monetare dhe depozitat afatshkurta. Vlera e humbjeve në zhvlerësim është imateriale në pasqyrat financiare.

Investime në letra me vlerë

Rreziku i kredisë së portofolit të letrave me vlerë të investimit vlerësohet në bazë të të dhënave historike dhe vlerësimit të aftësisë së emetuesve të ndryshëm për të përmbushur detyrimet e saj kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare në afatin e shkurtër.

Të dhënat, supozimet dhe teknikat e përdorura për përlogaritjen e zhvlerësimit

Rritje e ndjeshme e rrezikut të kredisë

Për përcaktimin nëse rreziku i mospagimit të vlerës së investuar të një instrumenti financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, Fondit konsideron informacione të mbështetura dhe të arsyeshme, që janë të disponueshme pa kosto ose përpjekje të panevojshme. Kjo përfshin informacione dhe analiza sasiore dhe cilësore, bazuar në përvojën historike të Fondit dhe vlerësimet e specialistëve të rrezikut të kreditit si dhe duke përfshirë informacione mbi të ardhmen.

b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Për ekspozimet ndaj qeverisë shqiptare, rreziku i kredisë konsiderohet të jetë rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare nëse ka vonesë prej 30 ditësh ose më shumë në shlyerjen e një detyrimi ndaj Fondit.

Fondi konsideroi një instrument financiar që ka pasur një rritje të ndjeshme në rrezikun e kredisë kur një ose më shumë nga kriteret e mëposhtme sasiore, cilësore ose kthyes janë përmbushur.

Fondi monitoron efektshmërinë e kriterëve të përdorura për të identifikuar rritje të ndjeshme në rrezikun e kredisë, nëpërmjet rishikimeve të rregullta për të konfirmuar se kriteret janë në gjendje të identifikojnë rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë para se një ekspozim të jetë në dështim.

Përkufizimi i dështimit

Fondi konsideron që një aktiv financiar ka dështuar kur:

- debitori nuk ka gjasa të paguajë detyrimet e tij të plota ndaj Shoqërisë, pa qenë nevoja për veprime nga Shoqëria të tilla si realizimi i aktive të lëna si kolateral (nëse ka ndonjë të tillë); ose
- debitori është në vonesë prej më shumë se 90 ditësh për ndonjë ekspozim material ndaj Shoqërisë.

Në vlerësimin nëse një huamarrës është në dështim, Shoqëria konsideron tregues:

- cilësorë – p.sh. shkeljet e kushteve financiare të kontratës;
- sasiore- p.sh. vonesat në pagesë dhe mospagimi i ndonjë detyrimi tjetër nga i njëjti huamarrës; dhe

Të dhënat e përdorura në vlerësimin nëse një instrument financiar ka dështuar dhe rëndësia e tyre mund të ndryshojë me kalimin e kohës për të pasqyruar ndryshimet në rrethana.

Pasuri financiare të modifikuara

Kushtet kontraktuale të një pasurie financiare mund të modifikohen për një numër arsyesh, duke përfshirë ndryshimin e kushteve të tregut, dhe faktorë të tjerë që nuk lidhen me një përkeqësim aktual ose potencial të kredisë së homologisë. Një aset ekzistues, kushtet e të cilit janë modifikuar mund të çregjistruar dhe pasuria e rinegociuar e njohur si një e re me vlerë të drejtë në përputhje me politikën e kontabilitetit të përcaktuar në Note 7(c)(v).

Matja e HPK

Mjete Monetare dhe ekuivalentët e saj

Fondi zbaton një model 12-mujor të humbjeve të pritshme dhe paraqet ekspozimet me maturim afatshkurtër në përcaktimin e zhvlerësimit e mjeteve monetare dhe ekuivalentët e saj. Fondi nuk ka njohur humbje zhvlerësimi më dhe për 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022

Fondi Raiffeisen Invest Miks

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2023
(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

8. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

c) Rreziku i likuiditetit.

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Fondi mund të mos jetë në gjendje të gjenerojë burime të mjaftueshme monetare për të shlyer plotësisht detyrimet e tij ose mund t'i shlyejë në kushte të cilat janë materialisht jo të favorshme. Politika e Fondit dhe qasja e menaxherit të investimeve në menaxhimin e likuiditetit është të sigurojë, sa të jetë e mundur, se gjithmonë do të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet kur është e nevojshme, nën kushte normale dhe tensioni, duke përfshirë edhe shlyerjet e vleresuara të kuotave, pa shkaktuar papranueshmëri humbje ose duke rrezikuar dëmtimin e reputacionit të Fondit. Fondi ka aftësinë të marrë hua në terma afatshkurtër për të arritur marrëveshjen, pas miratimit nga AMF dhe deri në një limit të caktuar. Raste të tilla huamarrjesh nuk ka pasur gjatë vitit ushtrimor. Për të menaxhuar likuiditetin e përgjithshëm të Fondit, Shoqëria Administruese gjithashtu ka aftësinë të pezullojë rimbursimet nëse kjo konsiderohet të jetë në interesin më të mirë të të gjithë zotëruesve të njësisë. Në mungesë të detyrimeve të rëndësishme financiare, Shoqëria administruese monitoron rrezikun e likuiditetit bazuar në flukse kontraktuale të skontuara të parasë. Tabela më poshtë analizon aktivet dhe detyrimet financiare të Fondit në grupimet përkatëse të maturimit në bazë të periudhës së mbetur nga data e pasqyrës së pozicionit financiar deri në datën e maturimit kontraktual. Shumat në tabela janë flukset monetare kontraktuale të skontuara më 31 Dhjetor 2023 dhe 2022:

	Deri 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 deri 6 muaj	6 deri 12 muaj	Mbi 1 vit	Totali
31 dhjetor 2023						
Aktivët						
Aktive financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet të fitimit ose humbjes	-	5,182	26,118	-	149,731	181,030
Kuota në fonde investimit me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes	104,219	-	-	-	-	104,219
Paraja dhe ekuivalentë të parasë	32,186	-	-	-	-	32,186
Llogari të tjera të arkëtueshme	25	-	-	-	-	25
Totali	136,430	5,182	26,118	-	149,731	317,460
Detyrimet						
Të pagueshme ndaj Shoqërisë së Administrimit	292	-	-	-	-	292
Të pagueshme ndaj mbajtësve të kuotave	-	-	-	-	-	-
Detyrime të tjera	261	-	-	-	-	261
Aktive neto të atrueshme ndaj mbajtësve të kuotave	320,083	-	-	-	-	320,083
Totali	320,635	-	-	-	-	320,635
Rreziku i likuiditetit	(184,205)	5181,7941	26,118	-	149,731	(3,175)
Akumulimi	(184,205)	(179,023)	(152,906)	(152,906)	(3,175)	(3,175)

Fondi Raiffeisen Invest Miks

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2023

*(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)***8. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)****(c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)**

31 dhjetor 2022	Deri 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 deri 6 muaj	6 deri 12 muaj	Mbi 1 vit	Totali
Aktivët						
Investime në fonde të tjera investimi me VDNFH	-	-	-	25,131	118,799	143,930
Aktive financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithpëfshirëse	98,586	-	-	-	-	98,586
Paraja dhe ekuivalentë të parastë	7,186	-	-	-	-	7,186
Llogari të tjera të arkëtueshme	43	-	-	-	-	43
Totali	105,815	-	-	25,131	118,799	243,745
Detyrimet						
Të pagueshme ndaj Shoqërisë së Administrimit	275	-	-	-	-	275
Të pagueshme ndaj mbajtësve të kuotave	-	-	-	-	-	-
Detyrime të tjera	448	-	-	-	-	448
Aktive neto të atrueshme ndaj mbajtësve të kuotave	242,979	-	-	-	-	242,979
Totali	243,702	-	-	25,131	118,799	243,702
Rreziku i likuiditetit	(137,887)	-	-	-	118,799	-
Akumulim	(137,887)	(137,887)	(137,887)	(112,756)	6,043	-

Vlera neto që i atribuohen mbajtësve të njësive përfaqësojnë të gjithë Vlerën e Aktiveve Neto të fondit. Në llogaritjen e hendekut të likuiditetit supozohet se të gjithë mbajtësit e njësive do të shpengojnë njësi në të njëjtën kohë, gjë që nuk ka shumë gjasa. Tërheqja maksimale e fondit është -14.88%.

Fondi Raiffeisen Invest Miks

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

8. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

d) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimet në çmimet e tregut do të ndikojnë në të ardhurat e fondit ose në vlerën e zotërimeve të instrumenteve financiare. qëllimi i menaxhimit të rrezikut të tregut është të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimet ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, duke optimizuar kthimin në rrezik.

8. Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit

Fondi është i ekspozuar ndaj rrezikut të monedhës pasi janë të pranishme transaksionet në Monedhën Euro, përveç monedhës bazë të Deklaratave Financiare (monedha Lek). Si në 31 dhjetor 2022 dhe 2021, nuk ka pasuri materiale financiare apo detyrime, të cilat janë shprehur në një monedhë tjetër përveç Euros.

Kurset e mëposhtme të rëndësishme të këmbimit të aplikuara gjatë vitit:

Lek	31 Dhjetor 2023		31 Dhjetor 2022	
	Average rate	Reporting date	Average rate	Reporting date
EUR	108.75	103.88	114.23	118.92
USD	100.62	93.94	107.05	113.15

Ekspozimi i Kompanisë ndaj rrezikut të monedhës së huaj në 31 dhjetor 2023 dhe 2022 ishte si më poshtë:

31 dhjetor 2023	Balanca e mbetur	EUR	LEK	USD
		(shuma e përkthyer në mijë Lek)		
Mjete Monetare dhe ekuivalentët	32,188	32,188	-	-
Aktive financiare me VDNFH duke përjashtuar investimet ne fondet të tjera	184,203	184,203	-	-
Investime në fonte të tjera me VDNFH	104,219	104,219	-	-
Payable to the Management Company	(292)	(292)	-	-
Ekspozimi Neto	320,319	320,319	-	-

31 dhjetor 2022	Balanca e mbetur	EUR	LEK	USD
		(shuma e përkthyer në mijë Lek)		
Mjete Monetare dhe ekuivalentët	7,186	7,186	-	-
Aktive financiare me VDNFH duke përjashtuar investimet ne fondet të tjera	137,887	137,887	-	-
Investime në fonte të tjera me VDNFH	98,586	98,586	-	-
Të pagueshme ndaj Shoqërisë së Administrimit	(275)	(275)	-	-
Ekspozimi Neto	243,384	243,384	-	-

8. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**d) Rreziku i tregut (vazhdim)*****Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit***

Rreziku kryesor për të cilin janë ekspozuar portofolet tregtare është rreziku i humbjes nga luhatjet në flukset e ardhshme të mjeteve monetare ose vlerat e drejta të instrumentit financiar për shkak të një ndryshimi në normat e interesit të tregut (Vlerat aktuale neto të aktiveve dhe detyrimeve). Rreziku i normës së interesit menaxhohet kryesisht përmes monitorimit të mangësive të normave të interesit. Menaxhimi i rrezikut të normës së interesit kundrejt mangësive të normave të interesit shoqërohet nga monitorimi i ndjeshmërisë së aktiveve dhe detyrimeve financiare të Fondit kundrejt skenarëve të ndryshëm standard dhe jo standard. Skenarët standard të cilët shqyrtohen në interval të rregullt përshijnë një rritje ose rënie prej 100 pbs në të gjitha kurbat e kthimeve. Një analizë e ndjeshmërisë së Fondit nga një rritje apo rënie e normave të interesit të tregut (duke supozuar mungesën e lëvizjeve jo simetrike për kurbat e kthimeve dhe një pozicion konstant financiar) është si më poshtë:

Një analizë e ndjeshmërisë së Fondit ndaj një rritjeje ose pakësimi të normave të interesit të tregut (duke mos supozuar asnjë lëvizje asimetrike në kthesat e rendimentit dhe një pozicion financiar konstant) është si më poshtë:

2023

Norma e interesit	Rënie 100 pbs	Ritje 100 pbs
Efekti i Fitimit/(Humbjes)	4,865	(4,865)

2022

Norma e interesit	Rënie 100 pbs	Ritje 100 pbs
Efekti i Fitimit/(Humbjes)	2,992	(2,992)

e) Administrimi i rrezikut të kapitalit

Kapitali i Fondit përfaqësohet nga aktivet neto që i atribuohen mbajtësit të kuotave. Shuma e aktivitetit neto që i atribuohet mbajtësit të kuotave mund të ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme në baza ditore, pasi Fondi i nënshtrohet investimeve dhe tërheqjeve ditore sipas gjykimit të mbajtësit të kuotës. Objektivi i Fondit përsa i përket menaxhimit të kapitalit është të ruajë vazhdimësinë e tij me qëllim sigurimin e kthimit për mbajtësin e kuotës, sigurimin e përfitimeve për palët e tjera dhe ruajtjen e një bazë të fortë kapitali për të mbështetur zhvillimin e aktivitetëve të investimeve të Fondit. Për të ruajtur strukturën e kapitalit, politika e Fondit është si më poshtë:

- Monitorimi i nivelit të hyrjeve dhe tërheqjeve ditore në raport me situatën e likuiditetit duhet të mundësojë likuidimin e kërkesave brenda 7 ditëve nga dita e kërkesës së vlefshme.
- Shlyerja dhe emetimi i kuotave të reja duhet kryer në përputhje me ligjin dhe prospektin e Fondit. Kjo përfshin aftësinë për të kufizuar shlyerjet dhe për të kërkuar një minimum investimi në Fond. Administratorët e Shoqërisë Administruese monitorojnë kapitalin në bazë të vlerës së aktiveve neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave.

(i) Strategjia e investimit

Strategjia e investimeve të aktiveve të Fondit Raiffeisen Mix mbështetet në ligjin nr. 10198 “Per Fondet e Investimit Kolektiv” dhe rregulloret e dala në zbatim të tij, si dhe në politikën e brendshme të investimit të Shoqërisë Administruese, propozuar nga Komiteti i Investimit dhe miratuar nga Keshilli i Administrimit i Shoqërisë Administruese.

(ii) Kuadri ligjor

Në lidhje me investimet e aktiveve të Fondit, Raiffeisen Mix nën administrimin e Raiffeisen INVEST-Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a. i përmbahet ligjit nr. 10198, datë 10 dhjetor 2009 “Për Sipërmarrjet e përbashkëta të investimit” dhe prospektit të Fondit.

8. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**e) Administrimi i rrezikut të kapitalit (vazhdim)***(iii) Investimet e lejuara*

Sipas rregullores, aktivet e Fondit mund të investohen vetëm në instrumentet e mëposhtëm:

- tituj të transferueshëm dhe instrumente të tregut të parasë, që tregtohen në tregje të rregulluara ose në një bursë titujsh në Republikën e Shqipërisë, në një shtet të Bashkimit European apo në çdo shtet tjetër të lejuar nga AMF-ja;
- kuota të fondeve të investimit apo aksione të Fondeve të investimit, të liçencuara sipas ligjit nr.10198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, si dhe nga kuota ose aksione të sipërmarrjeve kolektive të investimit, të liçencuara në përputhje me standardet e Bashkimit European;
- depozita në institucione kreditimi, të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, në një nga shtetet anëtare të BE-së ose në çdo shtet të lejuar nga AMF-ja, të cilat mund të tërhiqen menjëherë ose që kanë afat maturimi jo më shumë se 12 muaj;
- instrumente financiare derivative;
- instrumente të tjera të tregut të parasë.

Shoqëria administruese duhet të respektojë kufizimet e investimit të parashikuara në Ligjin nr.10198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, si dhe ato të parashikuara në politikën e brendshme për menaxhimin e rrezikut.

Kufizimet e investimit dhe kufiri i lejuar

Fondi nuk mund të investojë më shumë se 20% të aktiveve të saj në depozita në të njëjtin institucion.

Fondi nuk mund të investojë më shumë se 5% të aktiveve të saj në tituj dhe instrumente të tregut të parasë të një emetuesi të vetëm.

Kufiri 5%, mund të rritet deri në:

- a) 10%. Në këtë rast, vlera totale e titujve ose instrumenteve të tregut të parasë, që mban Fondi te disa emetues, ku për secilin ka investuar mbi 5% të aktiveve, nuk duhet të tejkalojë 40% të vlerës totale të aktiveve të fondit;
- b) 35% në rastin e titujve dhe të instrumenteve të tregut të parasë, të emetuara ose të garantuara nga qeveria dhe autoritetet vendore të Republikës së Shqipërisë, shteteve të Bashkimit European, shteteve të tjera të lejuara nga AMF-ja, ose nga organizma publikë ndërkombëtarë, në të cilët bëjnë pjesë një ose më shumë shtete të Bashkimit European;
- c) 100% me miratimin e AMF-së, sipas disa kushteve të përcaktuara në Ligj.
- d) 25% në rastin e disa obligacioneve të veçanta, të emetuara nga institucionet kredituese të licencuara, të cilat e kanë selinë e regjistruar në Republikën e Shqipërisë, apo në një shtet të Bashkimit European apo të lejuara nga AMF-ja. Kur Fondi investon më shumë se 5% të aktiveve në këto lloj obligacionesh të emetuara nga një emetues i vetëm, atëherë vlera totale e këtij investimi nuk tejkalon 80% të vlerës totale të aktiveve të Fondit;

Fondi mund të investojë deri në 30% të aktivevetë tij në kuota apo aksione të një forme tjetër të sipërmarrjeve të investimeve kolektive. Shoqëria Administruese i menaxhon aktivet e Fondit sipas parimit të sigurisë afatgjatë dhe të një kthimi të përshtatshëm nga investimi, duke ruajtur një raport optimal mes rritjes së kapitalit dhe rrezikut të marrë përsipër. Objektivat afatgjatë për shpërndarjen e aktiveve të Fondit janë si më poshtë:

Klasa	Objektivi
Të ardhura fikse	68%
- Tituj të Qeverive dhe Korporatave që tregtohen në tregje të rregulluara dhe njësi në sipërmarrje të tjetëra të investimeve kolektive – Bono Investment Grade	30%
- Tituj të Qeverive dhe Korporatave që tregtohen në tregje të rregulluara dhe njësi në sipërmarrje të tjetëra të investimeve kolektive – Shqipëri; Tregjet në zhvillim; Rendiment i lartë	38%

Raiffeisen Invest Mix

Notes to the financial statements

*(Amounts in thousands of ALL, unless otherwise stated)***8. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)****e) Administrimi i rrezikut të kapitalit (vazhdim)**

Kapitali aksionar	30%
Tituj të tregtuara në tregje të rregulluara ose në bursa në vendet e zhvilluara si SHBA, Kanada, vendet e BE- së, Zvicra apo vendet e Paqësorit. Këto tituj janë në formën e kapitalit individuale ose njësi/ aksione të fondeve të investimit të tregtuara ose jo në bursë.	25%
<i>(iii) Investimet e lejuara (vazhdim)</i>	
Tituj të tregtuar në tregje të rregulluara ose në një bursë në tregjet në zhvillim në Evropë apo Azi. Këto tituj janë në formën e kapitalit individuale ose njësi/aksione të fondeve të investimit të tregtuara ose jo në bursë.	5%
Mjete monetare dhe ekuivalentet ose tregu	2%
Depozita bankare, marrëveshje riblerje, Mjete Monetare dhe ekuivalentët	2%

Këto objektiva janë orientuese dhe mund të ndryshojnë në varësi të kushteve të tregut dhe politikës së investimit. Shpërndarja e investimeve ka të ngjarë të ndryshojë me kalimin e kohës pasi karakteristikat e investitorëve ndryshojnë dhe si rrethanat e tregut ndryshojnë.

Politika e brendshme e investimeve të Shoqërisë së Administrimit.

Rreziku në investime ndërmerret vetëm nga anëtarë të Fondit dhe jo nga Shoqëria Administruese. Për të minimizuar këtë rrezik, Shoqëria Administruese ka përfshirë në strukturën e saj organizative, Komitetin e Investimeve, i cili propozon politikën për alokimin e pasurive dhe investimeve dhe një Njësi për Menaxhimin e rrezikut e cila kryen kontrollin sasior dhe cilësor të gjitha rreziqeve të lidhura me Fondin. Nuk lejohen të gjitha ato investimet, norma e kthimit e të cilave, është nën nivelin e tregut, sepse kjo do të rrezikojë ekuilibrin e lidhjes investime - rrezik.

Pasqyra e strukturës së investimeve më 31 dhjetor 2023 dhe 2022 paraqitet si më poshtë:

	Vlera në datën e raportimit	Si % të totalit të aktiveve të fondit
Obligacione Qeveritare	147,198	46%
Obligacione të korporatave	37,005	12%
Kuota në fonde investimit	104,219	33%
Paraja dhe ekuivalentë të saj	32,188	10%
31 dhjetor 2023	320,610	100%
	Vlera në datën e raportimit	Si % të totalit të aktiveve të fondit
Obligacione Qeveritare	108,641	45%
Obligacione të korporatave	29,246	12%
Kuota në fonde investimit	98,586	40%
Paraja dhe ekuivalentë të saj	7,186	3%
31 dhjetor 2022	243,659	100%

Raiffeisen Invest Mix

Notes to the financial statements

(Amounts in thousands of ALL, unless otherwise stated)

9. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare

Përcaktimi i vlerës së drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare të tregtuara në tregje aktive bazohet tek çmimet e kuotuar të tregut ose në çmimet e shitësit. Vlera e drejtë e instrumenteve të tjera financiare përcaktohet përmes teknikave të vlerësimit. Teknikat e vlerësimit përfshijnë teknikën e vlerës aktuale neto, metodën e skontimit të flukseve monetare, krahasimin me instrumente të ngjashme për të cilat ka çmime tregu dhe modelet e vlerësimit.

Qëllimi i teknikave të vlerësimit është të arrijë një matje me vlerën e drejtë që pasqyron çmimin që do të merret për të shitur aktivin ose paguar për të transferuar detyrimin në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes.

Fondi e mat vlerën e drejtë duke përdorur Nivelin 1 dhe Nivelin 2 të hierarkisë së vlerës së drejtë, i cili reflekton rëndësinë e elementëve të përdorur në realizimin e vlerësimit, që shpjegohet si më poshtë:

- **Niveli 1:** Të dhënat për Nivelin 1 janë çmimet e kuotuar në treg për aktive dhe detyrime të ngjashme që entiteti mund të aksesojë në datën e matjes. Çmimi i kuotuar në treg përfaqëson dëshminë më të besueshme të vlerës së drejtë dhe përdoret pa u axhustuar për të matur vlerën e drejtë, me disa përjashtime.
- **Niveli 2:** Teknikat e vlerësimit të bazuara në elementet e vëzhgueshëm, në mënyrë direkte ose jo direkte. Kjo kategori përfshin instrumente të vlerësuar nëpërmjet çmimeve të instrumenteve të ngjashëm të kuotuar në tregje aktive; çmimet e kuotuar të instrumenteve të njëjta ose të ngjashme në tregje jo shumë aktive; ose teknika të tjera vlerësimi, ku të gjithë elementet e rëndësishme vëzhgohen në mënyrë direkte ose jo direkte nga të dhënat e tregut.

Modelet e përdorura për të përcaktuar vleran e drejtë janë të vlefshme dhe të rishikuara periodikisht nga Shoqëria e administrimit. Inputet në modelet e shumëfishta përfshijnë të dhëna të vëzhgueshme, të tilla si shumat e fitimeve të kompanive të krahasueshme me portofolin e Fondit përkatës dhe të dhëna të pavrojtueshme, siç janë parashikimet e fitimeve për Fondin e portofolit.

Mjete Monetare dhe ekuivalentët përfshijnë para në dorë dhe llogaritë rrjedhëse me bankat rezidente. Duke qenë se këto ekuilibra janë afatshkurtra, vlera e tyre e drejtë konsiderohet të barazohet me sasinë e tyre të mbartjes.

Investimet në letra me vlerë

Investimet në letra me vlerë përfshijnë bono thesari dhe obligacione të qeverisë. Vlera e drejtë e tyre llogaritet duke përdorur modelin e flukseve të skontuara të parave bazuar në normën e brendshme aktuale të kthimit e përshtatshme për maturitetin e mbetur.

Kuota në fonde të tjera investimi

Vlera e drejtë për këto letra me vlerë është vlerësuar duke përdorur çmimet e kuotave ditore të publikuara rregullisht për fondet përkatëse të investimeve.

Raiffeisen Invest Mix

Notes to the financial statements

*(Amounts in thousands of ALL, unless otherwise stated)***9. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare (vazhdim)***Mjete Monetare dhe ekuivalentët dhe depozitat*

Tabela e mëposhtme analizon në kuadër të hierarkisë së vlerës së drejtë aktivet financiare të Fondit (në bazë të klasës) i matur me vlerën e drejtë më 31 Dhjetor 2023 dhe 31 Dhjetor 2022.

Të gjitha matjet e vlerës së drejtë të publikuara janë matje te vlerës së drejtë periodike.

<i>31 dhjetor 2023</i>	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Totali
Obligacione te qeverise Shqipëtare	-	-	116,750	116,750
Obligacione te qeverive te tjera	-	30,449	-	30,449
Obligacione te korporatave	-	37,005	-	37,005
Fonde Investimi	104,219	-	-	104,219
	104,219	67,454	116,750	288,423
<i>31 dhjetor 2022</i>	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Totali
Obligacione të qeverisë Shqiptare	-	-	102,796	102,796
Obligacione te qeverive te tjera	-	5,845	-	5,845
Obligacione te korporatave	-	29,246	-	29,246
Investime ne fonde te tjera	98,586	-	-	98,586
	98,586	137,887	-	236,473

Të gjitha matjet e vlerës së drejtë të publikuara janë matje te vlerës së drejtë periodike.

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Aktivet financiare me VDNFH	184,204	137,887
Investime në fonde të tjera me VDNFH	104,219	98,586
Totali	288,423	236,473

Vlerësimet janë përgatitur dhe shqyrtuar në baza te rregullta nga vlerësimi i Menaxherit të rrezikut që raporton dhe i jep rekomandime shoqërisë administruese në bazë ditore, në përputhje me vlerësimet ditore që janë dhënë për investitorët. Menaxheri i rrezikut konsideron përshtatshmërinë e modelit të vlerësimit, të dhënat hyrëse kryesore si dhe rezultatin e vlerësimit duke përdorur metoda të ndryshme të vlerësimit dhe teknika përgjithësisht të njohura si standarde në kuadër të industrisë. Teknika e vlerësimit është zgjedhur dhe kalibruar në blerjen e titujve themelore të portofolit. Në përcaktimin e përshtatshmërisë të teknikës së zgjedhur të vlerësimit, Menaxheri i rrezikut mund të kryejë testimin përsëri duke marrë në konsideratë rezultatet aktuale të modeleve të ndryshme dhe se si ata historikisht janë në një linjë me transaksionet aktuale të tregut. Përveç kësaj, Banka e Kujdestarisë është përgjegjëse për rishikimin e rivlerësimeve përmes një procedure të konfirmimit ditor.

Për investimet në fonde të tjera investimi me vlerë të drejtë nëpërmjet kuotave të fitimit ose humbjes do të vlerësohet vlera neto e aktiveve për kuotën e sipërmarrjes përkatëse, sipas publikimit, pra, vlera e kuotës në dispozicion në ditën e vlerësimit.

Në rast se vlera neto nuk është publikuar, ose nuk është në dispozicion në ditën e vlerësimit, vlera e drejtë e kuotës që shërben si bazë e llogaritjes do të jetë çmimi më i fundit i publikuar për atë sipërmarrje nga kompania përkatëse e administrimit. Fondi nuk ka bërë të ditur vlerat e drejta për pasuritë financiare dhe detyrimet financiare që nuk maten me vlerë të drejtë, sepse sasia e tyre mbartëse është një përafrim i arsyeshëm me vlerë të drejtë.

Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë paratë në dorë, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në bankat rezidente. Duke qenë se këto bilanc janë afatshkurtra, vlera e tyre e drejtë konsiderohet të jetë e barabartë me vlerën e tyre kontabël.

Raiffeisen Invest Mix

Notes to the financial statements

*(Amounts in thousands of ALL, unless otherwise stated)***10. Të ardhura neto nga interesat**

Të ardhurat nga interesat e instrumentave finansiare sipas kategorisë përbehen si më poshtë :

	2023	2022
Obligacione të Qeverisë dhe korporatave	4,059	5,098
Të ardhurat nga interesi i depozitave	227	
Totali i të ardhurave nga interesat	4,286	5,098

Investimet në obligacione kanë interesa nga 1.125% - 3.875% në vit për obligacionet e korporatave dhe nga 1.% -5.9%për obligacionet qeveritare (2022: Investimet në obligacione kanë interesa nga 1.125% - 2.875% në vit për obligacionet e korporatave dhe nga 2.2-5.625% për obligacionet qeveritare).

11. Ndryshime të tjera në vlerën e drejtë të aktiveve finansiare të mbajtura në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes

Ndryshimet në vlerën e drejtë detajohen si më poshtë :

	2023	2022
Fitime/humbje te realizuara nga investimet	1,966	(49,437)
Fitime/humbje te perealizuara nga investimet	13,631	(11,752)
Ndryshimi total në vlerën e drejtë të aktiveve finansiare	15,596	(61,189)

Gjatë vitit 2023 të gjitha fondet nën menaxhim patën ecuri pozitive neto vjetore. Të dy fondet në ALL kanë rikuperuar humbjet e vitit 2022 gjatë gjysmës së parë të vitit 2023, ndërkohë fondet në EUR kanë rikuperuar pjesërisht humbjet e vitit 2022, për shkak të faktit se Bankat Qendrore në mbarë botën kanë vazhduar të rrisin normat e interesit.

Viti 2022 ishte një vit sfidues për tregjet finansiare dhe fondet tona gjithashtu. Rritja e ndjeshme e normave të interesit si në tregjet vendase ashtu edhe në ato ndërkombëtare bëri që si bonot ashtu edhe tregjet e aksioneve të përjetojnë performanca negative dhe kjo ka qenë e njëjtë në mbarë botën, jo vetëm për fondet që Raiffeisen investon ka nën administrim

12. (Humbje)/ fitime neto nga kursi i këmbimit

	2023	2022
Humbje të realizuara nga transaksionet e këmbimit valutor	(15,315)	(1,927)
Fitime /(humbje) të perealizuara nga transaksionet e këmbimit valutor	(6,333)	19,810
Totali	(21,648)	17,883

Varianca në fitim/humbje nga Forex ndërmjet dy viteve, lidhet me një luhatje të ndjeshme të kursit të këmbimit të euros me monedhën vendase LEK. Monedha e sipërpërmendur përdoret kryesisht në rrjedhën normale të biznesit.

13. Aktive finansiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes

Aktivet finansiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes janë paraqitur si më poshtë :

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Obligacione Qeveritare dhe korporatash	184,203	137,887
Totali	184,203	137,887

Raiffeisen Invest Mix

Notes to the financial statements

*(Amounts in thousands of ALL, unless otherwise stated)***14. Kuota në fonde investimit me vlerë të drejte nëpërmjet fitimit ose humbjes**

Fondi ka arritur në përfundimin se fondet e palistuar te investimeve me fund te hapur në të cilat ajo investon, por që nuk konsolidohen, plotësojnë përkufizimin e entiteteve të strukturuar për shkak se:

- ✓ Të drejtat e votimit në fonde nuk janë të drejta dominuese për të vendosur se kush i kontrollon ato, sepse të drejtat kanë të bëjnë vetëm me detyra administrative;
- ✓ Aktivitetet e secilit fond janë të kufizuara nga prospektet e saj; dhe fondet kanë objektiva të ngushta dhe të përcaktuara mirë për të ofruar mundësi investimi për investitorët.

Duke pasur parasysh natyrën e këtyre investimeve, ekspozimi maksimal i Fondit ndaj humbjeve është i barabartë me vlerën kontabël të investimit. Megjithatë, investimet e Fondit në këto subjekte mbahen kryesisht në përputhje me politikën e investimit në prospekt dhe shumica e rrezikut nga një ndryshim në vlerën e investimit të Fondit përputhet me një ndryshim në politikën e investimit në prospekt.

Investimet në kuota përfshijnë investimet si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Kuota në fonde të tjera	104,219	98,586
Totali	104,219	98,586

Investimet në njësi përbëhen nga investimet si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Ishare-CORE E. STOXX50 ETF	15,563	-
Vanguard FTSE All World High Dividend Yield ETF(A)	10,770	11,413
Raiffeisen-Sustainable-Equity	8,903	8,941
Ishare STOX.EUROPE 600 U.ETF	20,896	20,453
VANGUARD S&P 500U ETF DLD	20,444	18,609
MSIF - Euro Corp. Bd- Dur. Hgd	10,905	11,035
Lyxor Dow Jones Industrial Average ETF (A)	16,739	16,658
Lyxor EUR 2-10Y Inflation Expectations UCITS ETF		11,476.20
Totali	104,219	98,586

Gjatë vitit që përfundon më 31 dhjetor 2023, Fondi nuk ka ofruar mbështetje financiare për njësitë e strukturuar të pakonsoliduara dhe nuk ka për qëllim të ofrojë mbështetje financiare ose mbështetje të tjera. Fondi mund të tërheqë njësitë në fondet e sipërpërmendura të investimeve në çdo moment dhe në çdo kohë.

15. Mjete Monetare dhe ekuivalentët

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Llogaritë rrjedhëse me bankën kujdestare	11,410	7,186
Totali i llogarive rrjedhëse	11,410	7,186
Depozita	20,776	
Interesi I përlllogaritur	2	
Totali i depozitave	20,778	
Totali i parasë dhe ekuivalentë te saj	32,188	7,186

Në date 29.12.2023 Fondi ka vendosur nje depozite me Raiffeisen Bank.

Raiffeisen Invest Mix

Notes to the financial statements

*(Amounts in thousands of ALL, unless otherwise stated)***16. Detyrime të tjera**

Detyrimet e tjera përfshijnë tatimin në burim mbi të ardhurat personale të mbajtur nga Shoqëria Administruese në lidhje me përfitimet kapitale nga tërhiqjet e kontributorëve gjatë muajit Dhjetor. Shoqëria Administruese vepron si agjent mbledhës për Fondin, sipas ligjit nr. 8438 “Tatimi mbi të ardhurat” i datës 28.12.1998.

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Detyrimet për organet tatimore	1	-
Tarifa e bankës depozitare	15	14
Tarifa rregullatore e pagueshme	12	9
Detyrime të tjera	234	425
Totali	261	448

17. Aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Aktive neto që i atribuohen kontribuesve më 1 janar	242,978	534,143
Kontributet e emetuara gjatë vitit	103,520	47,027
Kontribute të tërhequra gjatë vitit	(22,266)	(295,768)
	324,231	285,402
Rritja në aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave gjatë vitit	(4,148)	(42,425)
Gjëndja më 31 dhjetor	320,083	242,978
Aktivët për njësi në Lek	10,228	10,446

Ne kemi qenë në gjendje të kufizojmë rrezikun e tregut duke reduktuar ekspozimin ndaj instrumenteve me rrezik të lartë brenda rrethanave të mundshme. apo edhe pasi bankat qendrore dolën me politika monetare të rritjes së normave të interesit ne jemi përpjekur të reduktojmë kohëzgjatjen e portofolit duke shitur.

Raiffeisen Invest Mix

Notes to the financial statements

(Amounts in thousands of ALL, unless otherwise stated)

18. Palët e lidhura

Palët konsiderohen si të lidhura në qoftë se njëra palë ka aftësinë për të kontrolluar palën tjetër ose të ushtrojë ndikim të rëndësishëm mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare ose operacionale.

Palët e lidhura të Fondit janë Raiffeisen INVEST - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a, e cila menaxhon Fondin, banka kujdestare e Fondit dhe Raiffeisen Bank sh.a. si aksionar i vetëm i shoqërisë administruese.

Që nga dhe për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2023 dhe 2022 Fondi ka hyrë në transaksionet dhe balancat e mëposhtme me palët e lidhura me të.

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Depozita		
Depozita ne Raiffeisen Bank	20,776	-
Interesi I llogaritur	2	-
	<u>20,778</u>	<u>-</u>
Detyrime ndaj Shoqërisë Administruese		
Tarifë e pagueshme ndaj Shoqërisë administruese	(292)	(275)
	<u>(292)</u>	<u>(275)</u>
Të ardhura		
Të ardhura nga interesat e depozitave	227,413	-
	<u>227,413</u>	<u>-</u>
Shpenzime		
Tarifa e Shoqërisë administruese	(3,178)	(5,201)
Totali	<u>(3,178)</u>	<u>(5,201)</u>

19. Ngjarje pas datës së raportimit

Nuk ka ngjarje të tjera pas datës së raportimit që mund të kërkojnë korrigjim ose shpalesje shtesë në pasqyrat financiare.